



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**  
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**  
**DEKANI**

**URDHËR I VEÇANTË**  
**08.05.2020**

Bazuar në Vendimin e Rektoratit me Nr.34 të datës 04.05.2020 sipas Urdhërit të "MASR" Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Nr.104 të datës 30.04.2020 për "**Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqesisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19**", në mbledhjen e zhvilluar në datë 04 Maj 2020, të Rektoratit të Universitetit të Arteve së bashku me strukturat e tjera të njëjësive kryesore UART si dhe ato administrative:

1. Rikthimin në auditore me datë 1 Qershor 2020 të studenteve të Vitit III Bachelor dhe studenteve të Vitit II Master që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për përsëritjen e lëndëve speciale, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike.

2. Ndryshimin e strukture vjetore të procesit mësimor për vitin akademik 2019-2020, me Nr.1041/4 prot..., datë 29.08.2019, sipas kalendarit akademik 2019-2020, si me poshte:

- a) 1 Qershor - 21 Qershor, realizimin e përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentet e vitit të tretë Bachelor dhe për studentet e vitit të dytë Master.
- b) 22 Qershor - 30 Qershor, zhvillimi i provimeve të mbartura si dhe java e e përgatitjes për provimet përfundimtare, sipas programeve të studimit për secilin fakultet në UART.
- c) 1 Korrik - 7 Gusht sezoni i provimeve, mbrojtja e diplomave, përmbjllja e dokumentacionit për diplomimin e studenteve të vitit të tretë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentet e vitit të dytë të ciklit të studimeve master.
- d) Vijimin e mësimit on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi.
- e) 31 Gusht - 2 Tetor, realizimi i përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentet e vitit të parë dhe të dytë të Ciklit I Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të Ciklit II Master.
- f) 21 shtator - 2 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura, si dhe përgatitja për provimet përfundimtare.
- g) 3 Tetor - 25 Tetor, sezoni i provimeve.
- h) 26 Tetor - 31 Tetor, Sezoni i provimeve të vjeshtës, si dhe përmbjllja e dokumentacionit.

3. Ngarkohen Përgjegjësit e Njësive Bazë për hartimin e orarit mësimor me kapacitet të reduktuar si dhe numrin e studentëve me qëllim minimalizimin e tyre nëpër atelie, laboratore, lektoriume etj.

4. Ngarkohet administratorii I FAB për pastrimin dhe higjenizimin e mjediseve si dhe marrjen e masave për dizinfektimin sipas Rregullores së miratuar nga MASR dhe rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik.

**PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI**

**DEKAN**  
**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**